

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,  
SEZONI 2021/2022  
(Java e parë, deri më 09.01.2022)**

**Të dhëna javore**


Gjatë **javës së parë** të vitit 2022 (nga 03-09.01.2022), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **470 (I=22,7/100.000)** të gripit/sëmundjeve të ngjashme me gripin.

Gjatë javës së parë pranë laboratorit të virusologjisë në ISHP RMV kanë arritur 224 materiale për analiza laboratorike për vërtetimin e pranisë së virusit të gripit 9 nga të cilat janë analizuar paralelisht edhe për prani të KOVID-19 dhe 40 (17,9%) kanë rezultuar pozitive për prani të virusit të gripit-35 nga mbikëqyrja rutinore dhe 5 nga mbikëqyrja sentinel SARI, të gjitha Influenza A të pasubtipizuara. Nga rastet pozitive të mbikëqyrjes rutinore, tek 5 mostra është vërtetuar prania e njëkohëshme e gripit dhe Kovid-19.

Numri i rasteve të regjistruara në javën e parë ka shënuar një rritje prej 26,1 herë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (n=18) dhe poashtu edhe një rritje për 39,0% në krahasim me lakoren sezonale tipike (të modeluar për 10 vitet e fundit) (n=770). (Grafiku 1)

Incidenca e raportuar është nën kufirin javor të aktivitetit sezonal të gripit (I=30,9/100.000), ende nuk është arritur pragu u fillimit të sezonit të gripit. (Grafiku 1)

**Grafiku 1.** Intenziteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike 2010-2021, sezoni 2019/2020, sezoni 2020/2021 dhe sezoni 2021/2022




Sa i përket moshës, 270 persona janë në moshë nga 15-64 vjet, 121 nga 5-14, 64 në moshë nga 0-4 vjet, dhe 15 mbi 65 vjet. Incidencë më e lartë (61,5/100.000) është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet.

Të sëmurë janë regjistruar në 15 QSP/NJR, Dibër – 156, Tetovë- 78, Gostivar – 62, Kavadar – 42, Kumanovë-29, Veles dhe Shkup – 27, Ohër-24, ndërsa QSHP/NJR e tjera numri është më i vogël se 10.

Në 9 njësi raportimi gjatë kësaj jave është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 5 është regjistruar aktivitet i ulët, në një (Dibër) aktivitet shumë i lartë (kartogrami 1).

## **Kartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, java e parë**



### **Të dhëna kumulative**

**Gjatë sezonit 2021/2022** numri i përgjithshëm i të sëmurëve arrin **2.183 ( $I=105,5/100.000$ )**, 5,5 herë më shumë se sezonin e kaluar ( $n=397$ ) dhe 7,2% më pak krahasuar me lakoren tipike sezonale ( $n=2.036$ ).

Raste të gripit dhe sëmundjeve të ngjashme me gripin kanë raportuar 18 QSHP/NJR. Numër më të madh të të sëmurëve ( $n=764$ ) dhe incidencë më të lartë kumulative ( $2.710,2/100.000$ ) është regjistruar në NJR Dibër. (Tabela 1)

Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar tek grupmosha nga 15-64 vjet – 1.254 raste (57,4%), ndërsa incidencë më e lartë kumulative ( $323,0/100.000$ ) tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet ( $n=336$ ).

**Që nga fillimi i sezonit 2021/2022**, deri në javën e parë, pranë laboratorit të virusologjisë në ISHPRMV kanë arritur gjithsej 3.034 materiale për testim paralel. Janë regjistruar 101 raste pozitive, 98 Influenza A/H3, 2 Influenza A e pa subtipizuar dhe një Influenza B.

Shpërndarja e rasteve me grip sipas muajve (Tabela 1):


- tetor – 102 raste ose 4,7%
- nëntor – 307 raste ose 14,1%
- dhjetor – 1.304 raste ose 59,7%
- Janar - 470 raste ose 21,5%

### **MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE**

**Që nga fillimi i sezonit 2021/2022**, deri në javën e parë, pranë laboratorit të virusologjisë në ISHPRMV kanë arritur gjithsej 3.990 materiale për testim paralel. Janë regjistruar 213 raste pozitive, 144 Influenza A/H3, 28 Influenza A e pa subtipizuar dhe një Influenza B. (Grafiku 2).

Janë regjistruar 5 raste të infektimit me grip dhe KOVID-19 njëkohësisht.

**Grafiku 2.** Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip 2021/2022



## KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rritje e numrit të të sëmurëve me grip, i cili vazhdon të jetë nën kufirin e aktivitetit sezonal. Tashmë 3 javë me radhë rezultatet e fituara gjatë mbikëqyrjes epidemiologjike janë mbi kufirin e pozitivitetit prej 10%, që paraqet një tregues për hyrjen virusologjike në sezonin e gripit. Sipas këtyre të dhënave RMV ka një përhapje rajonale dhe intenzitet mesatar të aktivitetit të virusit të gripit. Zvogëlimi i numrit të rasteve të raportuara duhet shqyrtuar me kujdes duke marrë parasysh se kjo periudhë i përfshin festat e fundvitit dhe Krishtlindjet.

## VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2021/2022, Ministria e shëndetësisë siguroi 40 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 20.000 doza shtesë të vaksinës katërvalente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2021/2022 filloi në 12.11.2021 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vakcinacija.mk](http://www.vakcinacija.mk).

Sipas të dhënave nga Drejtoria për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit deri në 13.01.2022 me vakcina falas janë vaksinuar gjithsej 44.835 persona të kategorive vullnerable të popullatës. (Tabela 2)

11.900 vakcina shtesë jani siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, sipas të dhënave nga QSHP/NJR, deri më tani janë vaksinuar 4.401 persona. Numri më i madh i tyre janë në moshë nga 30-64 vjet- 2.660 persona ose 60,4%, mbi 65 vjet – 1.414 persona ose 32,1%, nga 15-29 vjet janë gjithsej 179 ose 4,0%, nga 5-14 vjet 26 ose 0,6%, ndërsa nga 0-4 vjet janë vaksinuar 5 ose 0,1%. Janë vaksinuar edhe 120 punonjës shëndetësor, nuk ka gra shtatzëna të vaksinuara. Nga numri i përgjithshëm i të vaksinuarve 1.401 persona (31,8%) janë me sëmundje kronike. (Tabela 3)

Qendra e shëndetit publik Koçan me Njësitë Rajonale (Koçan, Berovë, Dellçevë dhe Pehçevë) dhe Qendra e shëndetit publik Strumicë nuk kanë dërguar të dhëna për numrin e personave të vaksinuar me vakcina komerciale në territorin e tyre.

**Deri në javën e parë, në RMV janë vaksinuar gjithsej 49.236 persona me vakcina falas.**

## **RAJONI EVROPIAN**

Sipas raportit të Flu News Europe të publikuar për javën e 52-të vitit 2021, aktiviteti i virusit të gripit është në rritje në mbarë rajonin Evropian.

- 23% e mostrave të analizuara nga pacientë me simptoma kanë rezultuar pozitive për virusin e influencës, me dominancë të Influenza AH3.
- 6 vende kanë raportuar aktivitet të gripit sezonal mbi pragun e pozitivitetit prej 10%. Armenia(78%), Izraeli(68%), Franca (33%), Moldavia (24%) dhe Shqipëria (18%).
- Janë raportuar hospitalizime të rasteve të konfirmuara në laborator nga repartet e kujdesit intenziv dhe rasteve nga SARI.
- Janë detektuar edhe Influenza A edhe Influenza B, me një dominancë të A(H3).

Sipas treguesve kualitativ në raport me intenzitetin, 19 vende janë në nivel bazik, 10 me intenzitet të ulët, 1 me intenzitet mesatar (Republika e Maqedonisë së Veriut. Sipas shpërndarjes gjeografike, 9 vende nuk kanë regjistruar aktivitet të virusit të gripit, 10 kanë raportuar raste sporadike, 2 vende shpërndarje lokale, 4 shpërndarje rajonale dhe 5 përhapje të gjerë gjeografike.

**Departamenti i epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive  
Instituti i shëndetit publik**